



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura e VIII**

*Sesioni vjeshtor*

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Mbledhja nr. 47**

**Prishtinë, më 6.02.2024, ora 13:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204**

**PROCESVERBAL**

Morën pjesë: Hydajet Hyseni Kaloshi, zëvendëskryetarë, Arjeta Rexhepi, Valentina Bunjaku Rexhepi, Enis Kervan, Shemsedin Dreshaj, Fridon Lala dhe Bekim Arifi, anëtarë.

Munguan: Bahrim Shabani, Drita Millaku, Elmi Reçica, Adem Hoxha dhe Fadil Gashi

Të pranishëm të tjerë: Sehar Gurizi dhe Violeta Haniqi asistente të GP Multietnik, Orgest Topojani, asistent i GP-PDK dhe Celal Iliaz, Drejtorja për media dhe marrëdhënie me publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasa Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni Kaloshi, zëvendëskryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 13 dhe 14 dhjetor 2023;
3. Miratimi i Raportit vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2023;
4. Shqyrtimi i draft planit të punës së Komisionit, për sesionin pranveror 2024;
5. Të ndryshime.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 13 dhe 14 dhjetor 2023.**

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me 13 dhe 19 tetor 2023, u miratuan pa vërejtje.

### **3. Miratimi i Raportit vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2023;**

**Zëvendëskryetari**, tha se në bazë të zhvillimit të punës së Komisionit për vitin 2023, është hartuar Raporti i punës, me bashkëpunim të stafi mbështetës, i cili ka ofruar mbështetje të nevojshme ligjore dhe teknike në përputhje me kompetencat e komisionit që janë të përcaktuara në pjesën narrative. Në bazë të rezultateve të prezantuara në raport, shihet pasqyra reale e punës së komisionit. Ai konsideron se këtë vit, komisioni do të jetë më azhur dhe ti shtyj përpara çështjet me prioritet.

Meqë nuk pati diskutime, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni në bazë të votimit unanim, nxori këtë:

#### **Përfundim**

Miratohet Raporti i punës së Komisionit, për vitin 2023.

### **4. Shqyrtimi i draft planit të punës së Komisionit, për sesionin pranveror 2024;**

**Zëvendëskryetari**, e informoi komisionin se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni përgatitë Planin e punës, për sesionin pranverorë për vitin 2024. Ai bëri një koment të shkurtër hyrës mbi detyrimet, qëllimin dhe domosdoshmërinë e hartimit të Planit të punës, i cili është udhërrëfyes për aktivitetet e komisionit dhe mundëson funksionimin e tij më të mirë.

Duke u bazuar në fushëveprimin e komisionit, në Plan të punës përfshihen aktivitetet dhe objektivat e komisionit, siç janë: raportimi i ministrave të linjës, procedurat e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, vizitat në terren me autoritetet Komunale, dhe çështjet tjera me prioritet.

Fjalën për diskutim iu dha anëtarëve të komisionit për të ofruar propozimet apo sugjerimet eventual, në mënyrë që i njëjti të miratohet.

**Enis Kervan:** tha se draft plani i punës së komisionit është një dokument i rëndësishëm ku bazohen aktivitetet e komisionit për vitin 2024. Shprehu qëndrimin e tij se do të mbështet hartimin e planit të punës, me mundësi të inkorporohen propozimet tona.

Sipas propozimit të tij, në muajin shkurt, të ftohet në raportim ministri për Komunitete dhe Kthim me temë: programi i punës së Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2024.

Sa i përket çështjes së zbatimit të Ligjeve, fillimisht të procedohet monitorimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve ndërsa në periudhën e dytë monitorimi i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Në mbledhjen e radhës, Komisioni do të caktojë grupin punues lidhur me monitorimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, i cili do të realizojë detyrat në bazë të dispozitave të ligjit. Mendon se duhet të angazhohen ekspertë për të ofruar mbështetje në fusha të caktuara.

Si propozim tjetër ishte, të vizitohet Komuna e Prizrenit dhe Vushtrrisë. Sipas zhvillimeve të punës, do të ofrojmë propozimet që të vizitohen edhe komunat tjera.

Ngriti edhe një çështje tjetër, në emër të komisionit do të procedohet shkresa për një vizitë studimore në Republikën e Turqisë, me qëllim të forcimit të bashkëpunimit ndër parlamentar me interes të përbashkët me Republikën e Turqisë.

**Arijeta Rexhepi**, ishte e mendimit se draft plani i punës së komisionit është një dokument i bazuar në kompetenca dhe përgjegjësit e komisionit, për vitin aktual. Ajo konsideron se do të miratohet Plani i punës së Komisionit për vitin 2024, me mundësi që i njëjti të rishikohet dhe ndryshohet në përputhje me kërkesat dhe nevojat e Komisionit. Që të realizohet në plotëni plani i punës, konsideron se duhet përpjekje e vazhdueshme që të realizohen afatet kohore.

**Valentina Bunjaku Rexhepi**, pajtohet me diskutimet e parafolësve se do të miratojmë Planin e punës për vitin 2024. Ishte e mendimit që i njëjti të plotësohet dhe ndryshohet në bazë të vlerësimit të kërkesave tona, ku si objekt shqyrtimi janë çështjet e rëndësisë së veçantë.

**Zëvendëskryetari**, ai propozoi që të miratohet plani i punës për vitin 2024, me ndryshimet e paraqitura nga anëtarët e komisionit lidhur me aktivitetet dhe objektivat e komisionit.

Pas diskutimeve, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni në bazë të votimit unanim, nxori këtë:

### **Përfundim**

Miratohet Plani i punës së Komisionit, për sesionin pranveror 2024, me ndryshimet e propozuara nga anëtarët e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

**Hydajet Hyseni Kaloshi,**  

---

**Zëvendëskryetar i Komisionit**